

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJGJEVE PËR VITIN 2025

Periudha (Prill 2025)

Nr . Re nd or	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfund imit të kërkesë s	Tarifa
12	25.03.2025	1.A ka pasur Bashkia juaj buxhet vjetor të planifikuar për rininë (grup moshën 15-29 vjeç) për periudhën janar-dhjetor 2024? Nëse po, sa përqind të shumës totale të buxhetit zënë këto zëra? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka një planifikim të tillë? 2.Sa është numri total i punonjësve në Bashkinë (2024)? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? 3.Sa është numri i të rinjve (18-29) punonjës të bashkisë në vitin 202? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? 4. Sa është numri i të rinjve (18-29) të punësuar në bashkinë tuaj, të cilët mbajnë pozicione drejtuese dhe vendimmarrës? (zv.kryetar,drejt,or, etj.). Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? 5.A ka bashkia juaj politika rinore të zhvilluara specifikisht për grup moshën	03.04.2025	1.Po, bashkia Belsh ka patur buxhet vjetor të palnifikuar për vitin 2024 për rininë (grup moshën 15-29 vjeç). Buxheti vjetor i planifikuar ka qenë 1 500 000 lekë Këto zëra zënë 1% të shumës totale të buxhetit. 2.Numri total i punonjësve të bashkisë në vitin 2024, ka qenë 235. Femra 106 Meshkuj 129 Persona me aftësi të kufizuar gjithësej 3 Femra 0 Meshkuj 3 3.Numri i të rinjve (18-29 vjeç) punonjës të bashkisë në vitin 2024, ka qenë 47. Femra 40 Meshkuj 7 Persona me aftësi të kufizuar gjithësej 0 Femra 0 Meshkuj 0 4.Numri i të rinjve (18-29 vjeç) të punësuar në bashki , të cilët mbajnë pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse (zv.kryetar, drejt,or, etj.). Femra 2 Meshkuj 2 5.Persona me aftësi të kufizuar gjithësej 0 Femra 0 Meshkuj 0	E plotë	Pa pagesë

		15-29 vjeç? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka të zhvilluar një politikë të tillë? 6.A keni në institucionin tuaj, drejtori, sektorë, staf të dedikuar për rininë? Prej sa kohësh janë funksionale? 7.A ka struktura rinore të ngritura në Bashkinë tuaj dedikuar grup moshës së rinjve 15-29 vjeç (qendra/zyra rinore, këshilla rinore, parlament rinor, struktura konsultative rinore, etj.) për periudhën janar-dhjetor 2024. Nëse po, cilat janë ato? 8.Me kë keni bashkëpunuar për ngritjen e strukturave të tilla (organizatar rinore, grupe të rinjsh, individë, etj.)? 9.A keni plan veprimi për Këshillin Vendor Rinor (KVR)? Sa aktivitete janë organizuar nga KVR përgjatë 2024? 10.Për çfarë lloj mbështetje/iniciativa/bashkëpunime keni nevojë për të përmirësuar funksionet e KVR në qytetin tuaj? 11.Sa të rinj janë të përfshirë në KVR? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? 12.A keni pasur ju forma të tjera bashkëpunimit (me grupe të rinjsh, organoizata rinore, etj.) për zhvillimin e aktiviteteve me në fokus rininë? Nëse po, ku kanë konsistuar ato? 13.Sa është me përafërsi pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet publike të		6.Bashkia Belsh nuk ka politika rinore të zhvilluara specifikisht për grup moshën 15-29 vjeç, një nga arsyet për mosrealizimin e këtyre politikave është mungesa e stafit dedikuar të rinjve. 7.Bashkia Belsh ka vetëm një punonjëse (specialiste) për Sportin dhe Rininë në sektorin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Arsimore, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, drejtori e cila tashmë është pjesë e Agjencisë së Shërbimeve të pa Transferueshme nën varësi të Bashkisë Belsh. 8.Bashkia Belsh ka të ngritur vetëm Këshillin Vendor Rinor. 9.Për ngritjen e Këshillit Vendor Rinor kemi patur bashkëpunimin e të rinjve, të drejtorit të shkollës, dhe të vullnetarit të Korpusit të Paqes. 10.Bashkia nuk ka një plan veprimi për Këshillin Vendor Rinor, ndërsa përse i përket aktiviteteve, KVR nuk ka organizuar asnjë aktivitet. 11.Bashkia ka nevojë për ambiente, Qendër Rinore për të realizuar takime, aktivitete, bashkëpunime me organizatat por jo vetëm, dedikuar të rinjve. 12.Në Këshillin Vendor Rinor janë të përfshirë 5 të rinj dhe Kryetari i Bashkisë. Nga këto 5 të rinj, 4 janë femra dhe 1 mashkull. Asnjëri nga të rinjtë nuk është me aftësi të kufizuara.	
--	--	---	--	---	--

		zhvilluara nga bashkia? Cilat janë disa nga mjetet apo mekanizmat që përdor bashkia në përfshirjen e të rinjve në të tilla proçese? 14.Lutemi listoni mjetet e komunikimit që përdor bashkia juaj dhe link përkatës të faqes së webit të bashkisë (website) dhe rrjetet sociale si Facebook dhe Instagram? 15.Sa është numri total i përfituesve nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2024? 16.Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 17.Sa është numri total i përfituesve të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 18.Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 19.Sa është numri total i personave të cilët janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 20.Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) të cilat janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?		13.Po, ka patuar forma të tjera ë bashkëpunimit për zhvillimin e aktiviteteve me në fokus rininë, si: Pjesëmarrja e të rinjve në një projekt me QSHINJNV me në fokus shëndetin mendor tek të rinjtë, gjithashtu edhe pjesëmarrja e të rinjve në Festën e Afërditës, në festën Nimfa e Liqeneve. 14.Pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet publike të zhvilluara nga bashkia gjatë vitit 2024 ka qenë afërsisht 20 %. Një nga mekanizmat e përdorura nga bashkia për përfshirjen e të rinjve në konsultimet publike është publikimi në rrjete sociale për zhvillimin e këtyre konsultimeve, rrjete të cilat janë më të aksesueshme nga të rinjtë, por gjithashtu dhe afishimin e informacionit në të gjitha njësitë e bashkisë. 15.Mjetet e komunikimit që përdor bashkia: arif.tafani01@hotmail.com fatmira.broshka@bashkiabelsh.gov.al https://bashkiabelsh.al/ https://www.facebook.com/bashkiabelsh2015/?locale=sq_AL https://www.facebook.com/p/Arif-Tafani-Faqja-Zyrtare-100063701572345/ https://www.instagram.com/arif_tafani_faqja_zyrtare/ https://www.instagram.com/accounts/login/?next=%2Fexplore%2Flocations%2F288254881836398%2Fbashkia-	
--	--	---	--	--	--

				belsh%2F&source=omni_r edirect 16.Numri total i përfituesve nga Skema e Ndhmës Ekonomike për vitin 2024 ka qenë 1690. Femra 855 Meshkuj 835 17.Numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të Skemës së Ndhmës Ekonomike për vitin 2024 ka qenë 105. Femra 50 Meshkuj 55 18.Numri total i përfituesve të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2024 ka qenë 1119. Femra 579 Meshkuj 540 19.Numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2024 ka qenë 60. Femra 33 Meshkuj 27 20.Numri total i personave qe janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024 ka qenë 87, të cilët kanë marrë shërbimet si më poshtë: -Tek qendra multifunksiionale “Nderim Brezash” kanë marrë shërbim 60 persona në total. Femra 18 Meshkuj 42 -Kanë marrë shërbim në NJMF 8 persona në total. Femra 2 Meshkuj 6 -Kanë marrë shërbim nga Koordinatorja Vendore e Dhunës në Familje 19 persona në total. Femra 14 Meshkuj 5		
--	--	--	--	---	--	--

				Numri i të rinjve (15-29 vjeç) të cilët kanë qenë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024 ka qenë 7 persona në total, të cilët kanë marrë shërbimet si më poshtë: -Tek qendra multifunktionale “Nderim Brezash” ka marrë shërbim 1 person. Femra 0 Meshkuj 1 -Kanë marrë shërbim në NJMF 4 persona në total. Femra 2 Meshkuj 2 -Kanë marrë shërbim nga Koordinatorja Vendore e Dhunës në Familje 2 persona në total. Femra 2 Meshkuj 0		
13	28.03.2024	1.Caktimi i vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike të partive politike në zgjedhjet për Kuvendin, të datë 11 maj 2025?	02.04.2025	1.Objektin ish-Vatra e Kulturës në Belsh (faqet e murit anësore nga rruga dhe faqja ballore nga karburanti)” dhe “Muri mbajtës i rrugës kryesore poshtë Lokalit të Agron Hysa”	E plotë	Pa pagesë
14	04.04.2025	1.Lëvizja Bashkë propozon për të miratuar hapësirat e mëposhtme publike për shpërndarje fletushkash: Belsh, te pedonalja (pranë bustit të Sami Frashërit)	04.04.2025	1.Përsa i përket propozimit nga ana juaj për të miratuar hapësirën publike në bashkinë Belsh te pedonalja (pranë bustit të Sami Frashërit) ju bëjmë me dije se propozimi juaj nuk miratohet. Sipas Vendimit nr. 205 datë 02.04.2025 të cilin ju kemi sjellë edhe më pare, vendi për shpërndarjen e fletushkave do të jetë vetëm pranë objektit ish-Vatra e Kulturës në Belsh sipas pikës 1 të këtij vendimi.	E plotë	Pa pagesë

15	04.04.2025	1.Rregullat dhe procedurat për dhënien e lejeve për të drejten e kalimit, të parashikuara ne VKM Nr. 155 datë 11.03.2022. 2.Rregullat dhe procedurat e miratuara në zbatim te ligjit për zhvillimin e territorit dhe VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” 3.Informacion mbi inspektimet që kryen bashkia për pikat e aksesit në infrastrukturë në godinat e reja dhe egzistuese në zbatim të VKM Nr. 155, datë 11.03.2022; 4.Gjithashtu është i nevojshëm bashkëpunimi me AKEP lidhur me publikimi në atlasin e broadband të AKEP të rrjetit të infrastrukturës pasive të ndërtuar nga bashkia sipas parashikimeve në VKM Nr. 851 datë 07.12.2016.	04.04.2025	1.Janë publikuar në faqen zyrtare të bashkisë Belsh, VKM e cituara nga ana juaj përkatësisht: VKM Nr. 155, datë 11.03.2022, VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”. 2.Përsa i përket investimeve në pikat e aksesit bashkia nuk ka realizuar dhe nuk kemi rrjet të infrastrukturës të ndërtuar nga bashkia sipas parashikimeve në vKM Nr. 851, datë 07.12.2016. 3.Personi i kontaktit: Ndriçim Reka Email: Ndricim.Reka@bashkia belsh.gov.al	E plotë	Pa pagesë
16	24.04.2025	1.Kërkesë për pajisjen me leje për zhvillimin e aktivitetit “Beko belshin 2025”, datë 26 Prill 2025?	25.04.2025	Bashkia Belsh, pasi shqyrtoi kërkesën tuaj, për dhënien e lejes për zhvillimin e aktivitetit “Beko Belshin 2025” më datë 26 Prill 2025, ora 16:00, në Sheshin Qendror të qytetit të Belshit, ju njofton se miraton kërkesën tuaj dhe lejon zhvillimin e aktivitetit në përputhje me qëllimin paqësor dhe shpirtëror të tij.Ju lutemi që gjatë zhvillimit të aktivitetit të respektohen rregullat e rendit dhe sigurisë publike.	E plotë	Pa pagesë